

Sjellja e politikave për sigurinë kombëtare dhe gjinia

PËRMBAJTJA

Pse është e rëndësishme gjinia për politikën e sigurisë kombëtare?

Si mundet që gjinia të përfshihet në politikën për siguri kombëtare?

Sfidat dhe mundësitë e pas konfliktit

Pyetjet për krijimin e politikës së sigurisë kombëtare

Më tepër informata

Ekziston njohje e madhe e asaj që reformat e sektorit të sigurisë (RSS) duhet të plotësojnë nevojat të ndryshme të sigurisë për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat. Integrimi i çështjes gjinore është kryesor për efektivitetin dhe llogaridhënien e sektorit të sigurisë, si edhe të pronësisë lokale dhe legjitimitetit të proceseve të RSS.

Ky shënim praktik mundëson një prezantim të shkurtër të përfitimeve të integritit të gjinisë në sjelljen e politikave kombëtare të sigurisë, si edhe informata praktike për integrimin e tyre.

Ky shënim praktik është pjesë e **Mjeteve praktike për RSS dhe Gjininë**. I dezenuar të mundësojë një prezantim për çështjet gjinore për praktikuesit e RSS dhe atyre që sjellin politikën, Mjetet Praktike përfshijnë 12 mjete praktike me shënimet gjegjëse praktike – shiko Më tepër informata.

Pse është gjinia e rëndësishme për politikën kombëtare të sigurisë?

Politikat Kombëtare të Sigurisë përcaktojnë qasjet e qeverisë dhe si pritjet që të arrihet siguria. Ata përfshijnë një strategji më të gjerë kombëtare të sigurisë, e cila mund të referohet edhe si plan, vizion, strategji, koncept ose doktrinë, si edhe si politika specifike të institucioneve, siç janë librat e bardha të mbrojtjes.

Gjini i referohet rolit dhe marrëdhënieve të veçanta, trajtimeve personale, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave të cilat shoqëria i ka parashikuar për meshkujt dhe femrat. Prandaj “gjinia” ju referohet ndryshimeve të mësuara midis meshkujve dhe femrave, përdërisa “seksi” ju referohet ndryshimeve biologjike midis meshkujve dhe femrave. Roli i gjinisë ndryshon qartë brenda dhe në mesin e kulturave, dhe mund të ndryshojë brenda kohës. Gjinia referohet ju thjeshtë vetëm femrave ose meshkujve por marrëdhënieve midis tyre.

Integrimi i çështjes gjinore në politikën e sigurisë kombëtare rrit rëndësinë dhe qëndrueshmërinë e saj:

Pronësia lokale nëpërmjet të proceseve pjesëmarrëse në sjelljen e politikave

- Konsultimet në përmasa të gjera për nevojat dhe prioritetet e sigurisë të cilat përfshijnë një spektër organizatave të shoqërisë civile për përfundimin e pronësisë lokale, legjitimitetin publik dhe ndihmojnë ndërtimin e konsensusit kombëtar për çështjet e sigurisë. Perspektivat e ndryshme të cilat organizatat e grave dhe të meshkujve mund të sjellin në tavolinë janë kritike.

Politika e gjithëmbarshme e sigurisë që ju drejtohet nevojave të ndryshme të sigurisë

- duke pasur parasysh nevojat e ndryshme të sigurisë dhe drejtësisë për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat na dërgon kah një politikë të gjithëmbarshme dhe efektive të sigurisë.
- Vëmendja kushtuar çështjes gjinore në politikën e sigurisë kombëtare thekson rëndësinë e të drejtuarit të kërcënimeve të brendshme të sigurisë, siç është dhuna bazuar në gjini (GBV).

Mos – diskriminimi në politikën e sigurisë dhe institucionet e sektorit të sigurisë

- Reduktimi i diskriminimit nga personeli i sektorit të sigurimit ndërton besimin, rrit legjitimitetin dhe përmirëson dispozitat e sigurisë dhe drejtësisë. Politika e sigurisë mund të vendosë rregulla mbrojtëse kundër diskriminimit brenda institucioneve të sektorit të sigurisë.

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Përputhja me obligimet sipas ligjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Integrimi i gjinisë në sjelljen e politikave të sigurisë kombëtare është e nevojshme të përputhet me ligjet ndërkombëtare dhe rajonale, instrumentet dhe normat lidhur me sigurinë dhe gjininë. Instrumentet kryesore përfshijnë:

- Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër femrave (1979)
- Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurisë Kombeve të Bashkuara për femrat, paqen dhe sigurinë (2000)

Për më tepër informata, ju lutemi shikoni Shtojcën e Mjeteve Praktike për Ligjet dhe Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale.

Shembulli 1 Çështjet e sigurisë të cilat duhet të përfshihen në politikën e sigurisë kombëtare

- Të drejtat e barabarta të meshkujve dhe femrave për pjesëmarrje në institucionet e sektorit të sigurisë;
- GBV si një kërcënim i brendshëm i sigurisë;
- Eliminimi i diskriminimit dhe shkelja e të drejtave të tjera njerëzore brenda institucioneve të sektorit të sigurisë ose në dispozitat e sigurisë dhe shërbimeve të drejtësisë;
- Mekanizmat të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile, përfshirë organizatat e grave, në mbikëqyrjen e implementimit të politikave të sigurisë, proceseve të RSS dhe institucioneve të sektorit të sigurisë.

Si mund të integrohet gjinia në politikat e sigurisë kombëtare?

Mbindërtimi ose revidimi i politikës kombëtare të sigurisë kërkon pjesëmarrjen e një spektri të gjerë të aktorëve, përfshirë edhe qeverinë kombëtare, parlamentin, vetëqeverisjen lokale dhe organizatat e shoqërisë civile (CSO). Secila tërësi e aktorëve mund të ndërmerr hapa në integrimin e gjinisë në sjelljen e politikave të sigurisë:

Qeveria kombëtare

(përfshirë organe koordinues të sigurisë dhe komisione që përpilojnë politikat e sigurisë)

- Ngritjen e kapaciteteve dhe përbetimin e funksionarëve dhe zyrtarëve të lartë që ti drejtohen çështjes gjinore në sjelljen e politikave të sigurisë nëpërmjet të trajnimeve, informatave të shkurtra dhe raporteve për çështjet gjinore, dhe programeve të mentorimit.
- Rritja e pjesëmarrjes së femrave në sjelljen e politikave të sigurisë nëpërmjet të:

- Emërtimit të femrave në këshillat kombëtare të sigurisë dhe komisionet që përpilojnë politikat e sigurisë.
- Përfshirë këtu edhe përfaqësues të organeve të sigurisë prej ministrive dhe/ ose organeve të tjera qeveritare ose komisioneve parlamentare përgjegjëse për çështjet gjinore dhe të femrave;
- Themelimi i mekanizmave për tu këshilluar me përfaqësuesit e organizatave të grave dhe ekspertëve gjinor për çështjet e politikave të sigurisë;
- Në veçanti të inkuadrojnë çështjet gjinore në politikat e sigurisë (shiko Kutia 1).
- Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore për evitimin e diskriminimit dhe përjashtimit – p.sh. ti referohen si “oficer i policisë” e ose polic dhe “kryesues” e jo “kryetar”.

Parlamenti

- Siguron që proceset e sjelljes së politikave të sigurisë të jenë përfshirëse dhe pjesëmarrëse nëpërmjet të:
 - Ndërmarrjes së proceseve të këshillimit me popullatën e gjerë (shiko Kutia 2).
 - Mbajtjen e sesioneve parlamentare, debateve të hapura dhe takimeve në komunë për të kërkuar informatat prej meshkujve dhe femrave nëpërmjet të shoqërisë për çështjet e sigurisë, dhe të diskutojnë draft politikat e sigurisë;
 - Mbajtjen e mbledhjeve të veçanta për grupet në shoqëri të cilat nuk dëshirojnë ose nuk mund të flasin publikisht – p.sh. grupet etnike minoritare;
- Të përpiqen për pjesëmarrje të barabartë të meshkujve dhe femrave deputet të parlamentit për sjelljen e politikave të sigurisë nëpërmjet të:
 - Promovimit dhe pjesëmarrjes së femrave parlamentare në komisionet e mbrojtjes dhe të sigurisë;
 - Inkurajim të femrave deputete dhe/ose deputetëve të interesuar në çështjet gjinore të kalojnë vijat partiake për përpilimin e platformës për çështje të sigurisë dhe gjinore;
 - Mbështetjen e themelimit të komisioneve/koalicioneve të femrave në parlament dhe brenda partive politike (shiko Rast studimi 2).

Vetëqeverisja lokale

- Involvimi i femrave, ekspertëve gjinor dhe përfaqësuesve prej organizatave të grave në komisionet dhe këshillat e sigurisë në nivel të komunitetit dhe revizioneve të sigurisë në komunitet;
- Të merren në konsiderim nevojat e ndryshme të sigurisë dhe drejtësisë për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat në parandalimin e krimit lokal dhe iniciativave përkatëse si edhe lidhur me çështjet e dhunës së bazuar në gjininë (GBV);
- Komunikimi i rezultateve pre revidimit të sigurimit dhe proceseve të planifikimit për organet rajonale dhe kombëtare të sigurisë, me qëllim të munden realitetet e sigurisë lokale për meshkujt dhe femrat të përfshihen në politikat kombëtare të sigurisë.

Organizatave e shoqërisë civile

- Lobimit për çështjet gjinore ti drejtohet në politikat kombëtare të sigurisë
- Të përfaqësojnë qëndrimet e meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat prej të gjithë shoqërisë, përfshirë këtu edhe atyre prej grupeve të marginalizuara, në proceset sjelljen e politikave të sigurisë;

Rast studim 1 Politika Kombëtare e Sigurisë të Xhamajkës—një proces përfshirës¹

Në mesin e vitit 2007 Qeveria e Xhamajkës miratoi një Politikë Kombëtare të gjithëmbarshme të sigurisë – Drejt një Kombi të sigurt dhe progresiv. Kjo politikë ishte e bazuar në Librin e Gjellbër të Strategjisë të Sigurisë Kombëtare e cila për herë të parë u dorëzua në Parlament në janar të vitit 2006, si dhe Libri i bardhë pasues për Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Fillimisht Qeveria e Xhamajkës planifikoi të zbatojë një shqyrtim të mbrojtjes. Gjithsesi, së shpejti u kuptua se kërkohej një qasje më e gjerë për t’ju adresuar spektrit ekzistues të rreziqeve potenciale ndaj sigurisë kombëtare, përfshirë krimin e organizuar, dhunën e bandave, bregat socio-ekonomike dhe katastrofën e mjedisit jetësor. U iniciua një konsultim me përmasa të gjera, duke përfshirë të gjithë degët relevante të qeverisë dhe agjencive shtetërore dhe CSO, përfshirë edhe grupet e femrave.

Nën kapitullin “Efektet e dhunës në komunitet” PSK kërkon vëmendje më të madhe për ndikimin e dhunës mbi individët, komunitetet dhe shoqërisë. “Dhuna familjare” theksohet aty, “është njëra nga format më depërtuese dhe të rëndomta të dhunës që e helmojnë shoqërinë. Ajo kontribuon në modelin e përgjithshëm të krimit dhe dhunës si rezultat i efekteve të saja të molisjes në sferën sociale dhe në rolin e saj në socializmin e rinisë me dhunën si mjet për zgjidhjen e konflikteve. Femrat dhe fëmijë janë në rrezik joproporcional prej dhunës familjare”.

- Mundësimin e grumbullit të njohurive teknike dhe ekspertizës së trajnimit për çështjet gjinore dhe të sigurisë për ata të cilët sjellin politikat e sigurisë dhe parlamentarët që të vështronjë ata;
- Monitorimin e çështjeve gjinore në implementimin e politikave të sigurisë;
- Zbatimin e revizioneve dhe vlerësimeve gjinore për politikat e sigurisë dhe institucionet e sektorit të sigurisë.

Shtembulli 2 | Konsultimet e politikës për sigurinë kombëtare duhet të përfshijnë

- Organizatat e grave të komuniteteve urbane dhe rurale
- Sindikatat e punëtorëve;
- Organizata fetare (religjioze);
- Liderët e komunitetit dhe aktivistët;
- Organizatat rinore
- Shoqatat vendore, etnike dhe të tjera minoritare
- Organizatat për drejtësi sociale
- Shoqatat e emigrantëve
- Shoqatat për personat me handicap
- Grupet e lobimit për fëmijët
- Akademikët dhe shkencëtarët
- Organizata ndërkombëtare

Trajnimi gjinor është një vegël e rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin dhe implementimin e politikës së sigurisë të bazuar në gjininë. Target grupet kryesore përfshijnë:

- Personelin e ministrive të involvuara në sjelljen e politikave të sigurisë, përfshirë personelin në ministrinë për mbrojtje, punët e brendshme dhe punët e jashtme;
- Anëtarët e organeve të koordinimit të sigurisë dhe komisioneve për përpilimin e politikave të sigurisë;
- Deputetët e Parlamentit në komisionet e sigurisë dhe personelin e tyre;
- Anëtarët e këshillave lokale qytetare të sigurisë ose forumeve policore të komunitetit;
- Shoqëritë civile (CSO) të cilat punojnë në politikat e sigurisë.

Llogaritja, monitorimi dhe vlerësimi gjegjës gjinor i politikave të sigurisë është i nevojshëm që të sigurojë që ata të plotësojnë nevojat meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat. Strategjitë të leverdishme përfshijnë:

- Analizat gjinore dhe socio-ekonomike të roleve dhe marrëdhënieve ekzistuese gjinore, në veçanti, dallimet në aktivitetet, qasja deri te resurset dhe vendimmarrja dhe pengesat e tjera ekonomike, sociale, politike dhe të tjera me të cilat ballafaqohen femrat dhe meshkujt;
- Vlerësimi i ndikimit gjinor të politikave të sigurisë për të përcaktuar potencialin ose ndikimin ekzistues të politikave të sigurisë mbi meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat;
- Analiza gjinore e buxhetit për përcaktimin e asaj se a thua fonde të barabarta dhe adekuate shpërndahen për plotësimin e nevojave të ndryshme të sigurisë dhe drejtësisë për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat.

Gjithashtu e mundësuar në Mjetet Praktike 8...

- Shembuj të gjuhës së ndjeshme gjinore në politikat kombëtare të sigurisë;
- Procesi prej pesë hapave për revidimin e sigurisë në komunitet;
- Aksione që mund të ndërmerren CSO të mbështetë sjelljen e politikave në baza gjinore;
- Pyetje për vlerësimin e ndikimit gjinor të politikave të sigurisë;
- Pyetje për analizat gjinore të buxhetit;
- Sfidat dhe mundësitë për integrimin e çështjeve gjinore në sjelljen e politikave gjinore në shtetet post-konfliktit, në tranzicion, në zhvillim dhe të zhvilluara.

Sfidat dhe mundësitë post-konfliktit

Reformat e sektorit të sigurisë (RSS) janë prioriteti kryesor në shtetet post-konfliktit, dhe politikat e sigurisë do të formojnë një bazë të rëndësishme për strukturimin e procesit. Sjellja e politikave të sigurisë mund të jetë mundësi për ri-negociata për rolet dhe përgjegjësitë lidhur me sigurinë të aktorëve të qeverisë si edhe atyre joqeveritar.

Sfidat për integrimin e çështjeve gjinore

- Institucionet dhe infrastruktura shtetëror mund të jenë të dobëta dhe me këtë të kenë kapacitete të kufizuara për zbatimin e proceseve të konsultimit të bazuara më gjerësisht. Kjo vetë shkakton kufizimin e përfshirjes së organizatave të grave dhe përfshirjen e çështjeve gjinore;
- Niveli i ulët i arsimit dhe mungesa e ekspertizës teknike mund të jenë pengesa për angazhimin e popullatës në proceset e sjelljeve të vendimeve, që ndikojnë te femrat dhe te disa grupe etnike në veçanti.
- Institucionet ekzekutive dhe të sigurisë mund të vështronjë CSO si kundërshtar politik dhe prandaj të hezitojnë të punojnë me organizatat e grave.

Rast studimi 2 | Integrimi i gjinisë në sjelljen e politikave të sigurisë: roli i femrave brenda ANC në Afrikën Jugore

Tranzicioni i Afrikës Jugore kah demokracia demonstroi se si mjedisi i favorshëm politik, formimi i ligës së grave brenda partive politike dhe lobimi për çështjet gjinore përgjatë spektrit mund të ndikojë mbi sjelljen e politikave të sigurisë kombëtare.

Hapësira politike për t'ju drejtuar çështjeve gjinore ishte krijuar brenda shoqërisë civile dhe partive politike. I brengosur për marginalizimin e grave, Kongresi Nacional Afrikan (KNA) Liga e Grave ishte reformuar në vitin 1990. Ata me bindje kërkoni përfshirjen e femrave në pozitat udhëheqëse dhe ngërthimin e barazisë gjinore në platformat dhe politikat e KNA. Lobimi i tyre është i qartë në botimin e KNA të vitit 1992 Gati për të qeverisur: Udhëzimet për një Afrikë Jugore Demokratike e cila ka pranuar se diskriminimi gjinor ose ka përjashtuar ose ka nënçmuar pjesëmarrjen e femrave në të gjitha institucionet socio-ekonomike dhe politike.³ Gati për të qeverisur propozon përqafimin e katër vlerave të lidhura mes veti: demokraci dhe autoritetet civile, sigurinë njerëzore, kundër-militarizimin, dhe barazinë gjinore. Ai thekson që ata duhet të respektojnë idealet e demokracisë, jo-racizmit, dhe jo-seksizmit dhe të pasqyrojnë përbërjen kombëtare dhe gjinore të shoqërisë së Afrikës Jugore.

Mundësitë për integrimin e çështjeve gjinore

- Marrëveshja për paqe mund të detyrojë përpilimin e politikave kombëtare të sigurisë që janë gjegjëse gjinore;
- Dialogu kombëtar me pjesëmarrje për sigurinë dhe pajtimet mund ta bëjë të mundshme edhe për femrat edhe për meshkujt të kenë zërin e tyre në identifikimin e nevojave dhe prioritetëve kombëtarë të sigurisë;
- Grupet e grave të shoqërisë civile të cilat kanë punuar për paqe dhe kanë mbështetur sigurinë në nivel të komunitetit gjatë kohës së konfliktit mund të ofrojnë ekspertizë të vlefshme për sjelljen e politikës së sigurisë;

Shembulli 3 Angazhimi i organizatave të grave në sjelljen e politikave të sigurisë

- Lehtësojnë inter-aksionin midis grupeve të grave dhe livruesve lokal të sigurisë – p.sh. nëpërmjet të përfshirjes në komisionet lokale të sigurisë;
 - Ngritjen e kapaciteteve të organizatave të grave për t'ju drejtuar çështjeve të politikës së sigurisë, përfshirë mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë;
 - Përfshijnë përfaqësues prej organizatave të grave si ekspertë në sesionet parlamentare.
- Reformat kushtetuese dhe zgjedhore të cilat rrisin përqindjen e femrave në parlament e bëjnë më të mundur për femrat të mbajnë pozita në organet për vendimmarrje të sigurisë;
 - Shkallët e rritura të GBV pas konfliktit mund të sjellin në frontin kryesor që nevojat që politika e sigurisë të përfshijë prevenimin dhe përgjigjen ndaj GBV si prioritet i sigurisë;
 - Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare mund të mbështesin proceset e sjelljeve të politikave të sigurisë në baza gjinore.

Pyetje për sjelljen e politikës kombëtare për siguri

Pyetjet kryesore për tu parashtruar për sigurimin e asaj që çështjet gjinore të jenë adresuar në sjelljen e politikave kombëtare të sigurisë, përfshijnë:

- A thua theksi është në sigurinë kombëtare ose njerëzore? A thua janë përfshirë kërcënimet e brendshme të sigurisë si dhe kërcënimet e përditshme të sigurisë njerëzore?
- A thua politika është përpiluar me pjesëmarrje, përfshirë këtu grupet e grave dhe të CSO-ve të tjera, personelit prej ministrive për çështjet e femrave, femrat parlamentare dhe ekspertë gjinor?
- Si i drejtohet politika nevojave të veçanta të sigurisë për meshkujt, femrat, djemtë dhe vajzat?
- KSi i drejtohet politika dhunës gjinore (GBV)?
- Si thekson politika rëndësinë e qëllimeve për barazinë gjinore, përfshirë mos-diskriminimin dhe pjesëmarrjen e barabartë të femrave dhe meshkujve?
- A është e përpiluar politika me gjuhë të ndjeshme gjinore?
- A është politika në vazhde me legjislacionin dhe politikën ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për çështjet gjinore?
- A thua politika do të implementohet, monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë përkatëse gjinore?

Më tepër informata

Burime

Susanna Bearne, Olga Oliner, Kevin A. O'Brien dhe Andrew Rathmell – *Struktura e vendimmarrjes së Sigurisë Kombëtare dhe Reforma e Sektorit të Sigurisë*, The RAND Corporation, 2005.

DCAF - *DCAF Historiati: Politika e Sigurisë Kombëtare*, 2005.

Iniciativa për siguri përfshirëse dhe alarmim ndërkombëtar – *Siguria përfshirëse, paqe e qëndrueshme: Një mjet praktik për Lobimin dhe Aksion* 2004.

OECD - *OECD DAC Doracaku për Reformat e Sektorit të Sigurisë: Mbështetja e sigurisë dhe drejtësisë*, 2007.

Kristin Valasek me Kaitlin Nelson – *Sigurimi i Barazisë, Rrezikimi i paqes: Udhëzues për Politikën dhe Planifikimin për femrat, paqen dhe sigurinë (Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurisë të KB), UN-INSTRAW*, 2006.

Mjetet Praktike për Gjininë dhe RSS

1. Reforma e Sektorit të sigurisë dhe Gjinia
 2. Reforma e policisë dhe Gjinia
 3. Reforma e Mbrojtjes dhe Gjinia
 4. Reforma e Drejtësisë dhe Gjinia
 5. Reforma Penale dhe Gjinia
 6. Menaxhimi i kufijve dhe Gjinia
 7. Mbikëqyrja parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 8. Sjellja e politikave të Sigurisë Kombëtare dhe Gjinia
 9. Mbikëqyrja e Shoqërisë Civile Civil e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
 10. Kompanitë Private ushtarake dhe të Sigurimit dhe Gjinia
 11. Vlerësimi i RSS, Monitorimi dhe Vlerësimi dhe Gjinia
 12. Trajnimi gjinor për Personelin e Sektorit të Sigurimit
- Shtojca për Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare dhe Rajonale

Secili prej këtyre mjeteve dhe shënimeve praktike janë në dispozicion në: www.dcaf.ch, www.un-instraw.org dhe www.osce.org/odihr

Këtë shënim praktik ka përgatitur Mugiho Takeshita nga DCAF, bazuar në Mjetet Praktike 8 të autorëve Peter Albrecht dhe Karen Barnes prej International Alert.

¹ National Security Strategy for Jamaica: Towards a Secure and Prosperous Nation, a Green Paper, revised in May 2006; and Stone, C. et al, Supporting Security, Justice, and Development: Lessons for a New Era, 2005.

² Anderlini, S.N. and Conaway, C.P., Negotiating the Transition to Democracy and Reforming the Security Sector: The Vital contributions of South African Women, (Washington DC: Women Waging Peace), 2004.

³ African National Congress (ANC), Ready to Govern, ANC Policy Guidelines for a Democratic South Africa adopted at the National Conference 28-31 May 1992.

<http://www.anc.org.za/ancdocs/history/readyto.html>